



# YOUR REFERENCES FOR TAX NEWS IN ALBANIA

---

## December, 2023

AEcO Business Solutions has created the Tax Newsletter, covering the period from January to December 2023 with the aim of providing both local and international businesses with answers to key questions regarding tax regulations in Albania

---



1.

## SKK 15 “Për kontabilitetin dhe raportimin financiar të mikronjësive ekonomike”, i përmirësuar

Për mikronjësitë pavarësisht të ardhurave që realizojnë, bëhet e detyrueshme përgatitja, paraqitja dhe publikimi i pasqyrave financiare të shkurtuara të paktën një herë në vit. *Ndryshimi i miratuar UMF nr.291 me date 30.12.2022* do të zbatohet në mënyrë prospective nga data 1 janar 2028 (që nënkupton pa ndryshuar PF krahasuese të vitit 2027)

2.

## Rritja e pages minimale në 40,000 ALL

Nga data 1 prill 2023, paga bazë minimale mujore për punonjësit në shkallë vendi, që është e detyrueshme të zbatohet nga çdo person, juridik a fizik, vendas ose i huaj, do të jetë 40,000 (dyzet mijë) lekë (për 174 orë pune në muaj). Paga maksimale, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore do të jetë 176,416 lekë. (Fletorja zyrtare nr. 34, dt 2.3.2023)







### 3.

#### **Ratifikohen 2 marrëveshjet midis Shqipërisë - Sllovakisë & Shqipërisë – Finlandës për eliminimin e taksimit të dyfishtë të të ardhurave**

Gjatë vitit 2023, i janë shtuar listës së Marrëveshjeve Ndërkombëtare për eliminimin e taksimit të dyfishtë në lidhje me tatimin mbi të ardhurat dhe parandalimin dhe shmangien e evazionit tatimor, dy shtete të reja: Finlanda dhe Sllovakia

Me hyrjen në fuqi të dy marrëveshjeve të reja, Shqipëria deri më tani ka ratifikuar 45 marrëveshje ndërkombëtare të Eliminimit të Taksimit të Dyfishtë.

### 4.

#### **30 prill 2023 afati i fundit i deklarimit të DIVA 2022 dhe pagesës së tatimit**

Individët rezidentë dhe jo rezidentë, të cilët gjatë vitit 2022 kanë pagë bruto vjetore mbi 2,000,000 lekë, ose ata të cilët janë të dypunësuar, të paktën për një periudhë tatimore brenda vitit, duhet të plotësojnë “Deklaratën individuale vjetore të të ardhurave”, brenda afatit 30 prill 2023.



## 30

**PRILL**

Afati i fundit  
i pagesës së  
Tatimit Mbi Të Ardhurat!

Subjekte deklaruese

**Total 74.029**

Mbi 2 mln lekë të ardhura

**16,732 individë**

Të dypunësuar

**57,297 individë**



## 5.

### **Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike**

Per here te pare ne Republiken e Shqiperise u vendos per burse per energjine elektrike. Objekt i këtij vendimi është parashikimi i procedurave të zbatimit dhe fillimit të aplikimit të regjimit të veçantë për Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike.



## 6.

### **Transferimi automatik i librave te shitjes dhe blerjes nga portali SelfCare drejt e-Filing .**

Duke filluar nga periudha tatimore Mars 2023, librat e shitjes dhe blerjes nuk do te ngarkohen manualisht, ne format excel nepermjet e-filing.

Transferimi i te dhenave te librave do të kryhet automatikisht ne E-filing, pasi tatimpauesi të ketë bërë mbylljen e tyre, ne portalin SelfCare, nga data 1-10 te muajit pasardhes.(Në të kundërt mbylljen automatikisht nga self-care pas datës 10 dhe dorëzohën nga sistemi në datën 11)

Perpara se te kryeni mbylljen e librave ne Portalin Selfcare, duhet të verifikoni te dhenat e transaksioneve dhe të kryeni saktësimet përkatëse.



## 7.

### **Shtesa dhe ndryshime ne Udhëzimin nr. 6/2015 , “Për TVSH-në në Republikën e Shqipërisë”**

Udhëzimi i ri nr.11 i dates 13.4.2023 ben disa shtesa dhe ndryshime ne udhëzimin e meparshem kryesisht në shtimin e përkufizimeve të reja të si më poshtë:

- Marrëveshje kuadër donacioni/granti,
- Marrëveshje vjetore donacioni/granti,
- Projekte konkrete,
- Zbatuesi i projektit,
- Përfituesi/it i/e projektit,
- Kontraktori,

Për qëllime të TVSH-së, trajtohet si furnizim i ngjashëm me eksportet, furnizimi i mallrave/shërbimeve, të destinuara për realizimin e projekteve të financuara me fonde të marra në bazë të një marrëveshjeje donacioni/granti, të lidhur ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë/Republikës së Shqipërisë dhe donatorëve të huaj, nëse në marrëveshje është parashikuar se fondet e marra nuk do të përdoren për të paguar tatime në Shqipëri.

Për të siguruar trajtimin me shkallën tatimore të TVSH-së 0%, zbatuesi ose përfituesi i projektit duhet të ndjekë procedurën e cituar sipas hapave në udhëzimin e ri.

Modeli i Deklaratës së Tatimit mbi Vlerën e Shtuar & Modeli i Librit të Shitjeve dhe Librit të Blerjeve do të zëvendësohen me modelin e ri të bashkalidhur udhëzimit. *(Deri në përmbylljet të vitit 2023, ndryshimi i modelit nuk është aplikuar në systemin tatimor online, e-filing të deklarimeve mujore)*





## 8.

### **Vendimi nr. 216, datë 13.4.2023 Për Krijimin dhe Funksonimin e Sistemit të Integruar Për Informatizimin e Manualit të Çmimeve për Zërat e Punimeve në Ndërtim**

Sistemi i integruar i informatizimit të manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim ("sistemi i integruar") unifikon metodologjinë e llogaritjes e të formatit të paraqitjes së preventivave dhe situacioneve, si dhe të analizave teknike të çmimeve për të lehtësuar veprimtarinë e subjekteve publike apo private, si dhe për lehtësimin e kontrollit tekniko-financiar në fushën e ndërtimit.

*Institucioni përgjegjës për gjenerimin dhe përditësimin e të dhënave në sistemin integruar është Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.*

## 9.

### **Udhëzimi nr. 13, datë 9.5.2023 "Për një ndryshim në udhëzimin nr. 16, datë 3.4.2020, "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit", të ndryshuar.**

Shoqëritë e huaja nëpërmjet përfaqësuesve të tyre tatimorë për TVSH, lejohen që për furnizimet në fushën e telekomunikacionit, transmetimit dhe shërbimeve elektronike, për persona të patatueshëm në Shqipëri, të kenë mundësi të lëshojnë një faturë fiskale tatimore, përmbledhëse periodike për shitjet totale të muajit jo më vonë se data 10 e muajit që pason muajin në të cilin janë dhënë shërbimet.

Gjithsesi, kjo procedurë e thjeshtuar, nuk pengon shoqërinë e huaj ose përfaqësuesin tatimor të saj, të lëshojë një faturë fiskale për cdo person dhe për cdo furnizim, në përputhje me procedurën e fiskalizimit.



## 10.

**Udhëzim Nr. 15, datë 12.6.2023  
“Për një shtesë në Udhëzimin Nr.  
24, datë 2.9.2008, "Për procedurat  
tatimore në Republikën e  
Shqipërisë", të ndryshuar”**

Gjobat për deklarata të pasaktë dhe pagesë të vonuar të detyrimeve për shkak të ndryshimit të listëpagesave dhe gjobat për deklarim të vonuar të formularëve të të punësuarve për herë të parë, atyre rishtazi, si dhe të larguarve nga puna, nuk aplikohen për organet e qeverisjes qendrore apo vendore, institucionet kushtetuese dhe institucionet e tjera që financohen nga buxheti i shtetit, në rastet:

- a) zbatim i një akti ligjor apo nënligjor me efekte prapavepruese;
- b) zbatim i një vendimi gjykate të formës së prerë;
- c) zbatim i një vendimi të Gjykatës Kushtetuese/ Gjykatës së Lartë;
- d) vonesave në nxjerrjen apo dërgimin e vendimeve të emërimit të punonjësve nga organet që kanë këtë të drejtë.

Këto gjoba nuk zbatohen pasi deklarimet apo ndryshimet e listëpagesave me vonesë nuk kanë ardhur për shkak të veprimit apo mosveprimit të institucioneve.

## 11.



**Disa ndryshime në Metodologjinë e Përcaktimit të Vlerës së Tatueshme të Pasurive të Paluajtshme “Ndërtesë”.**

Sipas vendimit nr. 457, datë 26.07.2023, “Për disa ndryshime në Metodologjinë e Përcaktimit të Vlerës së Tatueshme të Pasurive të Paluajtshme “Ndërtesë”, çmimet mesatare të referencës për shitblerjen e objekteve për banim në Shqipëri kanë ndryshuar në mënyrë drastike në disa prej zonave të territorit, veçanërisht për Bashkinë Tiranë.

Si pasojë e rritjes së çmimeve mesatare të shitblerjes së ndërtesave, rriten në të njëjtën masë edhe çmimet minimale të referencës për kontratat e qirasë, për të cilat subjektet do të duhet të deklarojnë dhe të paguajnë një taksë më të lartë në burim për qiranë.

- Në vijim jepet një paraqitje grafike dhe në % e këtyre ndryshimeve sipas zonave të Tiranës

## Disa ndryshime në Metodologjinë e Përcaktimit të Vlerës së Tatueshme të Pasurive të Paluajtshme “Ndërtesë” (Vazhdim)





## Ndryshime në Ligjin për Sigurimet Shoqërore

Tashmë në ligjin për Sigurimet Shoqërore është bërë shtesa lidhur me pagën maksimale si në vijim: “Paga maksimale, për efekt kontributi, rritet me të njëjtën masë dhe në të njëjtën kohë me masën që rritet paga minimale në shkallë vendi.”

Shtesa të tjera konsistojnë si më poshtë:

- Personat e punësuar me profesion në fushën e teknologjisë së informacionit (IT) dhe të regjistruar në subjektet me aktivitet kryesor në fushën e teknologjisë së informacionit, të cilët ushtrojnë aktivitetin e tyre sipas ligjit nr. 58/2022, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e parqeve teknologjike dhe shkencore”, të miratuara sipas legjislacionit në fuqi për këtë kategori, **paguajnë kontributet e sigurimeve shoqërore në nivelin e pagës minimale mujore në shkallë vendi, me miratimin paraprak të punëmarrësit, të evidentuar në kontratën e punës, pavarësisht pagës bruto të deklaruar.**
- Përfshihen nga detyrimi për të paguar kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore përfituesit e pensionit të pleqërisë, që vetëpunësohen si të vetëm në sektorin privat.
- Pagesa nuk ndalohet nëse përfituesi i pensionit të pleqërisë punon në sektorin privat si i punësuar apo i vetëpunësuar.
- Përfituesve të pensionit të pleqërisë, të cilët, ndërkohë që tërheqin këstin mujor të pensionit, janë të punësuar ose të vetëpunësuar në sektorin privat, nuk u njihet periudha e punësimit si periudhë sigurimi për efekte përfitimi nga ky ligj.

## Ndryshime në Ligjin për Sigurimin e Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor

- Personat e punësuar me profesion në fushën e teknologjisë së informacionit (IT) dhe të regjistruar në subjektet me aktivitet kryesor në fushën e teknologjisë së informacionit, të cilët ushtrojnë aktivitetin e tyre sipas ligjit nr. 58/2022, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e parqeve teknologjike dhe shkencore”, të miratuara sipas legjislacionit në fuqi për këtë kategori, paguajnë kontributet e sigurimeve shëndetësore në nivelin e pagës minimale mujore në shkallë vendi, me miratimin paraprak të punëmarrësit, të evidentuar në kontratën e punës, pavarësisht pagës bruto të deklaruar.

## Ndryshime në Ligjin për Nxitjen e Punësimit

Ndryshimet fokusohen tek Skema e garancisë rinore dhe në punësimin e personave me aftësi të kufizuara.

Janë përcaktuar më qartë hapat për rekrutimin dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara. Mbledhja e kontributit të derdhur nga ana e punëdhënësit nëse nuk ka të punësuar një person me aftësi të kufizuara për 25 punonjës (dhe nga një person shtesë për çdo 50 punonjës të tjerë të kompanisë), do të monitorohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nëpërmjet deklarimeve të Listëpagesave online.



## 15

### **Urdhër nr. 177, datë 2.8.2023: Për miratimin e përkthimit në gjuhën shqipe të ndryshimeve në SNK 12 - “Tatimi mbi të Ardhurat”**

Shpallen ndryshimet në Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit (SNK) 12 “Tatimi mbi të ardhurat”. Ky Standard zbatohet për tatimet mbi të ardhurat që rrjedhin nga legjislacioni tatimor i miratuar ose pothuajse i miratuar për zbatimin e modelit të rregullave të Shtyllës së Dytë të publikuar nga Organizata për Bashkëpunimin dhe Zhvillimin Ekonomik (OECD). Njësia ekonomike nuk do të njohë dhe nuk do të japë informacion shpjegues mbi aktivet dhe detyrimet për tatime të shtyra të lidhura me legjislacionin e Shtyllës së Dytë, si përjashtim nga kërkesat e këtij Standardi.



## 16

### **Ligj nr. 76/2023 “Për fondet e pensionit privat”**

Ligji ka për qëllim hartimin e një kuadri ligjor rregullator për krijimin, licensimin, administrimin dhe mbikëqyrjen e fondeve të pensionit privat në Republikën e Shqipërisë. Fletorja Zyrtare nr. 152, dt. 20.10.2023.



# CILAT JANË NDRYSHIMET LIGJORE TË PAKETËS FISKALE 2024 në Shqipëri ?

Në vijim ndryshimet e miratuara dhe në pritje për miratim në :

- Ligjin për TVSH-në
- Ligjin për Akcizat
- Ligjin për Proçedurat Tatimore
- Ligjin për Taksat Kombëtare
- Ligjin për Tatimin mbi të ardhurat .

## Ndryshime në Ligjin 9975/2008, “Për Taksat Kombëtare”, të ndryshuar

Në Nenin 3: Llojet e taksave kombëtare, Pika 6- Taksa e karbonit për qymyrin shtohet referenca sipas kreut të NKM **2704**

Në Nenin 3: Niveli i taksave kombëtare, ndryshohet pika 6 ku parashikohet rritje vit pas viti për nivelin e taksës për kilogram të karbonit për qymyrin nga viti 2024 e në vijim, si më poshtë:

- 3.5 lek/kg për vitin 2024
- 4.5 lek/kg për vitin 2025
- 6 lek/kg për vitin 2026
- 8 lek/kg për vitin 2027
- 10.3 lek/kg për vitin 2028
- 12.8 lek/kg për vitin 2029
- 15.3 lek/kg për vitin 2030 e në vazhdim

*\*Kjo taksë nuk paguhet për sasi të benzines dhe të gazoilit që eksportohen.*

Efektet e këtij ndryshimi shtrihen nga data 1 Janar 2024

## Për një ndryshim në ligjin “Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar

Parashikimet për ndryshimet e reja në Ligjin mbi Akcizat, ndryshohet **mënyra e llogaritjes** së taksës për të gjitha produktet e akcizës me përjashtim të duhanit dhe nënprodukteve të tij, për të cilat akciza aplikohet sipas kalendarit të përcaktuar më parë.

Akciza e llogaritur sipas projektligjit aktual indekskohet çdo dy vjet në masën e normës zyrtare të inflacionit të shpallur nga INSTAT-i, por jo më shumë se 1.5%, me përjashtim të duhanit dhe nënprodukteve të tij, për të cilat akciza do të aplikohet sipas kalendarit të përcaktuar në shtojcën nr.1

Efektet e këtij ndryshimi shtrihen nga data 1 Janar 2024





## Ndryshimet dhe shtesat në Ligjin nr. 9920/2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”

Kudo në përmbajtjen e ligjit:

- a) fjalët “... tatimit/n mbi fitimin ...” zëvendësohen me “... **tatimit/n mbi fitimin korporativ** ...”;
- b) fjalët “... tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël ...” zëvendësohen me “... **tatimit mbi të ardhurat personale nga biznesi** ...”.

Në nenin 5 të përkufizimeve të ligjit ka shtesa në terminologji .

Gjithashtu ka shtese një seksion të ri “**Raporti për çdo vend**” - *Çdo entitet mëmë përfundimtar i një grupi shoqërie shumëkombëshe, që është rezident për qëllime tatimore në Republikën e Shqipërisë, do të paraqesë një raport për çdo vend*

### **Në nenin për Dënimet Administrative shtohet**

→ Për njësitë e qeverisjes qendrore dhe të vetëqeverisjes vendore nuk aplikohen dënimet administrative të parashikuara nga ky ligj, në rastet kur mosdeklarimi në afat ka ardhur si rrjedhojë e zbatimit të një akti ligjor apo nënligjor me efekte prapavepruese apo zbatimit të një vendimi gjykatë të formës së prerë.

Mospagimi në afat i kësteve paraprake të tatimit mbi fitimin korporativ dhe tatimit mbi të ardhurat personale nga biznesi dhe vetëpunësimi, sipas legjislacionit në fuqi për tatimin mbi të ardhurat, dënohet me gjobë në masën **0,06 % të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë gjatë së cilës pagesa nuk është kryer, por jo më shumë se 365 ditë kalendarike** (nga sa ishte mw parw 10% të shumës së kështit për t'u paguar plus kamatëvonesën e llogaritur)

Efektet e këtij ndryshimi shtrihen nga data 1 Janar 2024



Ndryshime priten të miratohen dhe në lidhje me:

- dënimet për **mosdërgimin e dokumentacionit për zbatimin e dispozitave të marrëveshjeve për shmangien e tatimit të dyfishtë**) në afat.
- dënimet lidhur me **detyrimet e raportimit për çdo vend**.

**Shkeljet për moslëshimin e faturave dhe të faturave shoqëruese** për tatimpaguesin, i cili, për herë të dytë brenda vitit kalendarik, kryen një shkelje, të konstatuar të dyja herët në kuadrin e një kontrolli tatimor “verifikim në vend”, përveç masës së gjobës, merren edhe masa të tjera si më poshtë

- a) Gjobë prej 50 000 lekësh për tatimpaguesit e tatimit mbi të ardhurat personale nga biznesi apo vetëpunësimi, gjobë 100 000 lekë për tatimpaguesit e tatimit mbi të ardhurat personale nga biznesi apo vetëpunësimi me TVSH-në, gjobë 500 000 lekë për tatimpaguesit e tatimit mbi fitimin korporativ;
- b) Për tatimpaguesit e regjistruar për TVSH-në bëhet vlerësim tatimor për tre muajt e fundit, duke përdorur metodat alternative, të parashikuara në nenet 71 e 72, të këtij ligji;
- c) Masa e bllokimit të veprimtarisë në vendin ku është konstatuar shkelja për 30 ditë kalendarike. Masa e bllokimit, hiqet, nëse tatimpaguesi paguan penaltetet e vendosura.



## Ndryshimet e ndodhura në Ligjin 92/2014 “Për TVSH-ën”

Furnizimi i mallrave/ shërbimeve, të destinuara për realizimin e projekteve të financuara me fonde të marra në bazë të një marrëveshjeje donacioni/granti të lidhur ndërmjet Këshillit të Ministrave/ Republikës së Shqipërisë dhe donatorëve të huaj (nëse në marrëveshje është parashikuar se fondet e marra nuk do të përdoren për të paguar tatime) do të trajtohen si furnizime të ngjashme me eksportet.

Nga ana tjetër këto mallra, me cilësinë e mësipërme janë të përjashtuar nga TVSH në import.

Në grupin e furnizimeve të përjashtuara nga TVSH në import është shtuar edhe:

- **Importimi i kafshëve të gjalla racëpastër për riprodhim (speciet: gjedhe, dhen, dhi, derra dhe njëthundrakë) dhe materialit biologjik që përdoret për inseminimin artificial.**
- **Importimi i insekteve, të cilat përfshihen në kodet 0106 41 00, 0106 49 00 dhe 0106 90 00 të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave.**

## Miratohet në dt. 30.3.2023 Ligji nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i cili i shtrin efektet nga 1 janari 2024.

**Ky ligj vendos rregullat në lidhje me:**

- *Tatimin mbi të ardhurat tek personat fizikë dhe entitetet;*
- *Tatimin mbi të ardhurat nga trashëgimitë, dhurimet dhe fitimet nga lojërat e fatit.*

Janë qartësuar dhe shtuar perkufizime të ndryshme si psh. Selia e Perhershme etj, shtesa në nenet për tatimet nga Punesimi, Biznesi, Investimi .

Të ardhurat e mëposhtme konsiderohen si të ardhura të tatueshme të një tatimpaguesi të tatimit mbi të ardhurat personale:

- a) Të ardhura nga punësimi;
- b) Të ardhura nga biznesi;
- c) Të ardhura nga investimet.

*Baza tatimore vjetore zvogëlohet me kompensimet dhe zbritjet e përcaktuara sipas këtij ligji të ri.*

Është shtuar aplikimi me zgjedhje e i një regjimi të veçantë për individët tregtarë dhe të vetëpunësuar

Ndryshon metoda e amortizimit nga progresive në lineare

|                                                                                                  | <b><i>Baza tatimore vjetore</i></b> | <b><i>Norma tatimore</i></b> |
|--------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------|------------------------------|
| <b>Te ardhurat nga punesimi taten me normat progresive:</b>                                      | 0 - 2,040,000 Lekë                  | 13%                          |
|                                                                                                  | Mbi 2,040,000 Lekë                  | 23%                          |
| <b>Të ardhurat neto (fitimi) nga biznesi për individët tregtarë dhe të vetëpunësuarit taten:</b> | 0 - 14,000,000 Lekë                 | 15%                          |
|                                                                                                  | Mbi 14,000,000 Lekë                 | 23%                          |

Për:

- i. individët tregtarë;
- ii. të vetpunësuarit, si dhe;
- iii. entitetet, me të ardhura bruto deri 14 milion lekë në vit, norma e tatimit mbi të ardhurat 0% do aplikohet deri në fund të vitit 2029.

**Norma e tatimit 0 % nuk do aplikohet për tatimpaguesit e përmendur në gërmat (ii) dhe (iii) më sipër, të cilët furnizojnë shërbime profesionale.**

# PAKETA FISKALE 2024

Kontakto :  
AECO BUSINESS SOLUTIONS  
+355 68 403 9794  
+355 68 904 4437

[@aecobusinesssolutions](https://www.aecobusinesssolutions.com)

*Për një pasqyrim të plotë të ligjit të ri mbi Tatimin e të Ardhurave, referojuni Newsletter-it tone të radhës.*